



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **24.03.2026**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**. Kryesuesi konstatoi se, kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 27 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 27.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive komunale, sekretari e kuvendit, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie dhe ju të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Kjo është mbledhja e **tretë** e rregullt e legjislaturës 2025-2029 dhe në bashkëpunim me kryetarin kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, P-00214-1 ZK-Zoqisht;
3. Shqyrtimi dhe miratimi vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00214-1, ZK-Zoqisht;
4. Shqyrtimi dhe miratimi vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës P-02240-80, në zonën kadastrale Rahovec;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 31/25, të datës 28.3.2025, për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 50/25, të datës 29.4.2025, "Park Hotel Plaza", Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit nr. 36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 30m² (tridhjetë metra katrorë);
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, lokalit nr. 36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 30m² (tridhjetë metra katrorë), P-00413-2 ZK-Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 dhe 2025, në vitin 2026;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2026;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Rahovecit 2026 – 2028;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të draft-rregullores për Shërbime Publike 01 Nr.2917, i datës 26.10.2018;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë (objektit) te sheshi qendror;

13. Shqyrtimi dhe miratimi vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
14. Shqyrtimi i informatës së DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025-2026;
15. Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2025;
16. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.

Shtesë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi për plotësim-ndryshimin e vendimit 01Nr. 87/2026, i datës 20.01.2026 për formimin e komisionit për dhenien në shfrytëzim të Hotel Park Plazës P- 09038-2, ZK Rahovec;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës, 71510057-02240-80, ZK Rahovec.

Kryesuesi: Fillimisht, a e keni pranuar materialin me kohë dhe a keni ndonjë vërejtje lidhur me materialin, si dhe me rendin e ditës? Atëherë, ju njoftoj që pika e pestë e rendit të ditës ndryshohet pak nga emërtimi dhe formulohet kështu: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë P-09038-2, Hotel Park Plazës, ZK Rahovec.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, i nderuar kryesues! Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolegët anëtarë, përfaqësuesit dhe qytetarët. Kryesuesi është mirë të na njoftojë se pse në seancën e kaluar është ndërprerë incizimi i seancës? Nuk figuron incizimi të pika e pyetjeve dhe përgjigjeve deri në fund. E di që ekziston një kontratë për monitorimin e kësaj seance dhe meqë kryesuesi është përgjegjës për mbarëvajtjen e këtij transmetimi, a është kjo kontratë me orë, apo si? Sa i përket pikave të rendit të ditës, në KPF kam kërkuar që të formohen dy komitete. Kryesuesi ka kërkuar që përshkak të numrit të madh të pikave të rendit të ditës, këto pika të tërhiqen për mbledhjen e radhës. Në rregull, por njëkohësisht kërkoj që në seancën e radhës të formohen 4 komitete, ashtu siç e kemi paraparë në planin e punës së kuvendit. Sa i përket pikës së Hotel Park Plazës, kërkoj nga kryesuesi që zyra ligjore ta përgatit një vendim të plotë pa këto ndryshim-plotësime, sepse vendim që 5 herë është duke pësuar ndyshime. Kështu që, për t'ia lehtësuar punën komisionit, por edhe neve asambleistëve, që mos t'i kemi në dorë 5 vendime, kërkoj që të riformulohet një vendim i përgjithshëm.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Përshëndetje për të gjithë! Dua të ndërlihem me atë që tha Lirigzoni rreth xhirimeve të seancës. Jo vetëm në seancën e kaluar që në pikën e fundit nuk ka xhirime, por edhe para asaj seance. A po bëhet qëllimisht, apo ku është problemi?

Kryesuesi: Sa i përket incizimeve, sinqerisht tani po e kuptoj. Do të kujdesem rreth kësaj çështjeje. Nga Sekretaria mora informatë që jemi duke e pritur incizimin nga Ekonomia Online për ta bashkëngjitur në faqen e komunës. Përndryshe, janë të obliguar sipas kontratës ta bëjnë incizimin, prej fillimit deri në fund të seancës.

Kryetari: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, asambleistë, medie, KFOR. Besoj që përgjegjësia është te kompania mediale dhe nuk guxon të ndodh më kështu. Sa i përket pikave të rendit të ditës, e mirëkuptova Lirigzonin. Jam dakord me Lirigzonin dhe Vlorën, është e vërtetë që janë bashkuar parcelat, kanë marrë numra të ri, kanë marrë ligjshmëri etj... Realisht kërkojmë ndjesë, por pas bashkimit të parcelave situata ka ndryshuar. Sa i përket komiteteve, nuk mund të të siguroj që në muajin prill t'i formojmë 4 komitete, sepse edhe muaji prill parashihet të jetë i ngarkuar me pika të rendit të ditës. Gjithësesi, në seancën e muajit prill, minimum do të formohen 2 komitete, 2 të tjera mund t'i formojmë edhe në maj. Ju ftoj ta votoni rendin e ditës.

Kryesuesi: Nëse edhe dikush tjetër nuk ka diçka për të shtuar, ne po i vendosim në votim pikat shtesë, bashkë me riformulimin e pikes së pestë. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohen pikat shtesë të rendit

të ditës. Tani e vendosim në votim komplet rendin e ditës. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Në mënyrë unanime miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Në mënyrë unanime miratohet pika e parë.

Kryesuesi: Me kërkesë të kryetari, meqenëse është “Epopeja e Glllogjanit”, po ia kaloj fjalën kryetarit.

Kryetari: Nësër fillojmë me përvjetorët e masakrave, sot jam në një ngjarje. Nehar Shalës së LDK-së ia kam një borxh dhe e siguroj që do t’ia jap një përgjigje. Uroj që të kaloni sa më mirë.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, P-00214-1 ZK-Zoqisht:

Besmire Bytyqi: Faleminderit kryesues! Të drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit. Para jush e keni propozim vendimin e kryetarit të komunës, për miratimin e dhënies së pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme. Kjo pikë bëhet përmes procedurës së shprehjes së interesit. Parcela është në zonën kadastrale në Zoqisht në sipërfaqe prej 173m² e që ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3658m². Qëllimi: Rritja dhe ruajtja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin e aktivitetit biznesor në mënyrë që t’u jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen. Afati kohor i dhënies në shfrytëzim është afatgjatë – në periudhë prej 40 vjetësh. Në skicën e përgatitur, parcela gjendet në rrugën kryesore për Retijë, në pjesën e majtë është një objekt që pothuajse është i pashfrytëzueshëm.

Kryesuesi: A ka diskutues për këtë pikë? Nëse jo, unë dua ta bëj veç një pyetje: Nuk e di a duhet të ceket në vendim, apo në kontratë me operatorin që, ai që e merr në shfrytëzim këtë hapësirë në rast të mosekzekutimit të punëve, t’i rikthehet komunës përsëri, pavarësisht afatit 40 vjeçar. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 25 vota pro dhe 2 abstenime, miratohet vendimi.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00214-1, ZK-Zoqisht:

Besmire Bytyqi: Bëhet fjalë për formimin e komisionit për pikën paraprake që e votuam. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 prej tyre nga ekzekutivi, 2 nga legjislativi dhe 1 nga shoqëria civile.

Berat Duraku: Nga AAK, për këtë komision propozojmë Lendrit Morinën.

Lirigzon Kastrati: Nga LDK, Hazbije Shalën e kemi nga ai fshat, të cilën e propozojmë për këtë komision. Meqenëse ju i keni numrat, ne mund të tërhiqemi nëse ka propozimet të tjera.

Defrim Kafexhiu: Nga LVV nuk kemi propozim, por e mbështesim atë të grupit të LDK-së.

Melinda Oruqi Iska: Nga PDK propozojmë, Behlul Krasniqin.

Kryesuesi: I kemi 3 propozime dhe duhet t’i vendosim në votim. Kush është “për” Lendrit Morinën?... Kundër?... Abstenime?... Kush është “për” Hazbije Shalën?... Kundër?... Abstenime?... Kush është “për” Behlul Krasniqin?... Kundër?... Abstenime?... Atëherë, rezultati është ky: Lendrit Morina 15 vota, Behlul Krasniqi 15 dhe Hazbije Shala 12. Sipas numrit të votave, nga kuvendi në këtë komision do të jenë: Lendrit Morina (AAK) dhe Behlul Krasniqi (PDK). Meqë nuk është për moment i pranishëm kryetari, ne e autorizojmë që t’i vendosë dy emra nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Me 15 vota “për” dhe 1 votë kundër, miratohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës P-02240-80, në zonën kadastrale Rahovec:

Besmire Bytyqi: E keni pranuar propozimin e kryetarit për shpallje me interes të përgjithshëm të parcelës 02240-80, në zonën kadastrale Rahovec. Po kërkojmë që ta shpallim me interes të përgjithshëm sipërfaqen prej 9900m² dhe që ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7.512.400m². Kjo parcelë është në vendin e quajtur “Shum kabilja glava” dhe sipas certifikatës së pronësisë është pronë e Kosovës – pyjet. Qëllimi: Është fillimi i procedurave së këmbimit të

pronës komunale me pronën e institucionit qëndor për ndërtimin e kalasë, për nder të rënies së dëshmorit të kombit, Xhevdet Qazim Morina. Kjo parcelë gjendet te pjesa kur e kalon Zatriqin, rrugës për Malishevë. Në emailat e juaja e keni pasur edhe kërkesën e OVL-së në Malishevë, si dhe të gjitha skicat dhe matjet.

Jusuf Dërmala: Përshëndetje për të gjithë! Dua ta bëj një pyetje rreth kësaj prone. Nëse është e nevojshme që ta respektojmë këtë dëshmor (gjithsesi është e nevojshme që ta respektojmë një dëshmor), por prona të cilën duhet ta shpronësojmë mbi 90 ari, nuk më duket e arsyeshme që ta respektojmë një dëshmor, sepse dëshmori respektohet edhe me një bust. Pastaj, këtë pronë e keni të vendosur në listën e përgjithshme të publikimit të Drejtorisë së Kadastrës, e cila, sipas ligjit për dhënien e pronave në shfrytëzim, deri më 31 dhjetor 2025 ka afat për publikim. Nuk i kam parë disa prona të publikuara. Kërkoj sqarim!

Besmire Bytyqi: Faleminderit për pyetjen, Jusuf! Po, është e vertetë që lista e pronave duhet të publikohet deri më 31 janar, mirëpo me vendim të ministrit tuaj, afati është shtyrë deri më 31 mars. Publikimi i pronave në listën e përgjithshme dhe të veçantë bëhet vetëm për pronat komunale, ndërsa kjo pronë i takon Agjencionit të Pyjeve.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Nëse është mundësia që kur flasim për parcela, t'i vendosni në projektor, sepse do të ishte më e qartë për ne që nuk i takojmë lëmisë së arkitekturës, apo edhe lëmime të tjera.

Kryesuesi: Jusuf, po bëj përjashtim veç në këtë rast, përndryshe, kur e merr fjalën artikulohe më mirë.

Jusuf Dërmala: Drejtoreshë, në lidhje me vendimin e ministrit. Ne jemi duhet folur për pronën që tani duhet ta japim dhe këto prona duhet të jenë të publikuara deri më 31 dhjetor. Paraprakisht, ju nuk e keni publikuar.

Besmire Bytyqi: Jusuf, ashtu siç e ceka se me ligj publikimi është deri më 31 dhjetor, mirëpo ministri ka marrë vendim që të shtyhet afati deri më 31 mars, shkaku i shumë zgjedhjeve që janë mbajtur. Sot jemi më datë 24 dhe i kemi edhe pak ditë kohë që ta publikojmë, editojmë dhe plotësojmë listën e pronave. Gjithashtu, kjo pronë për të cilën po bisedojmë nuk ka nevojë për publikim, sepse është pronë e Agjencisë së Pyjeve.

Kryesuesi: Faleminderit! E para, në rend dite sot është këmbimi i pronës dhe jo dhënia në shfrytëzim. E dyta, publikohet lista e pronave komunale dhe jo e Agjencionit Pyjor. E treta, aty ku po mendohet të bëhet këmbimi i kësaj prone ka qenë një qëndresë gjatë periudhës së luftës dhe gjithsecili jemi të pajtimit që kjo të bëhet. Është normale të bëhen pyetjet për sqarim. Prona gjendet te Epopeja e UÇK-së.

Lirigzon Kastrati: Sapo e lexova edhe kërkesën e kryetarit të OVL-së nga nëndega e Astrazubit, ku flitet për dëshmorët dhe gjaku i derdhur na obligon brezave të tërë. Natyrisht që në emër të grupit e përkrahim.

Defrim Kafexhiu: Mos e vendosni në dyshim edhe Jusufin, ani pse bëri pyetje. Mendoj që çdo pronë duhet t'i përmbahet procedurave ligjore, si dhe për menaxhimin më të mirëfillt të pronave publike duhet t'i përmbahemi rregullave të publikimit. Është normale që jemi pro.

Kryesuesi: Nëse nuk ka diskutues të tjerë, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... A ka votë kundër?... Abstenim?... Me 25 vota “për” dhe 2 abstenime, miratohet vendimi. Vazhdojmë me pikën e pestë të reformuar.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë P-09038-2, Hotel Park Plazës, ZK Rahovec:

Kryesuesi: Këtu drejtori për Ekonomi do të duhej ta elaboronte pikën, por në mungesë të tij e ftoj zyrën ligjore.

Isak Hoti: Përshëndetje kryesues, drejtorë, asambleistë. Ashtu siç e tha edhe Lirigzoni, ky vendim është plotësuar dhe ndryshuar shpesh, për shkak se është bërë edhe bashkimi i disa parcelave në një parcelë si dhe ndarja e parcelave me numra të ndryshëm. Ky vendim është pëlqim paraprak për zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim deri në 99 vjet. Siç e keni parë në vendim të neni 7, ku thuhet: objektet përcjellëse për investime të pronës, pas mbarimit të afatit të dhënies në shfrytëzim të cekur në pikën 1 do t'i kalojnë në pronësi komunës. Pres që ky vendim të miratohet.

Enis Durguti: I nderuar kryesues, drejtorë, kolegë asambleistë. Fillimisht, edhe pse pak me vonesë, ju uroj të gjithëve festën e Bajramit. Ndërsa, te vendimi apo vendimet që i kemi para vetes, realisht është vendim – shfuqizim – vendim i ri që ka shumë përmirësime. Është e paqartë te pjesa e qirasë që është 2000 euro viti, rreth 170/180€ muaji. Nëse e

diskutojmë pjesën ligjore, qiranë është dashur ta vendosë komisioni. Sa po e shoh unë, qiranë e ka vendosur ekzekutivi dhe atë para se të hapet thirrja dhe para se të vendosen kushtet e thirrjes. Çfarë kushte duhet t'i ketë hoteli, a do të ndërtohet i ri, apo do të rinovohet? Askush nuk e dimë, sepse komisioni ende nuk i ka paraparë këto kushte, ndërsa qiranë e kemi. Qiraja është shumë e ulët nëse vendoset që hoteli të rinovohet, ndërsa, nëse vendoset që të rrënohet ky që është dhe të ndërtohet një i ri, atëherë unë do e bëja edhe pa qira (5 vjet). Unë jam pro investimeve në komunën e Rahovecit. Nëse është duke u përgatitur ky terren për një x person, atëherë le të bëhet pak më fshehtë. Nuk besoj që ka kuvendarë që është kundër investimit në Rahovec, të gjithë jemi pro, vetëm se duhet të bëhen ashtu siç duhet. Kërkoj sqarim, se qiraja a është obligim i komisionit dhe a po përgatitet ky projekt i madh për dikë? Apo është vetëm ndonjë gabim puna e këtij çmimi. Te pika e pestë ceket që 24 muaj do të jetë pa qira. Këtu jam dakord, por 24 muajt e ndërtimit apo rinovimit?

Qazim Cana: Përshëndetje kryesues, drejtorë, kolegë asambleistë, medie. Rreth hotelit: a është në kontest gjyqësor dhe a mund të vazhdohet me këto procedura për dhënie në shfrytëzim?

Bujar Mustafa: Unë po e kërkoj veç një sqarim, a do të ndahet pjesa e Park Plazës prej kësaj parcele? Apo është në pyetje komplet parcela?

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! Të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive. Kjo pikë është diskutuar mjaft edhe në mandatin e kaluar. Prej parafolësve u tha që është plotësuar dhe ndryshuar disa vjet dhe po jepet në shfrytëzim për 99 vjet. Te pjesa e pikës që caktohet edhe qiraja për vit, është shumë i ulët dhe është në kundërshtim me qëllimin e dhënies në shfrytëzim të pronës. Institucionet e tjera kur i japin pronat në shfrytëzim, si qëllim e kanë rritjen e vlerës së pronës. Arsyeja pse është shkëputur kontrata parakohshëm me qiramarrësin paraprak, është çështja që ajo pronë nuk e ka rritur vlerën me investimet e bëra nga ai që e ka pasur kontratën për shfrytëzim. Është e paarsyeshme që 2793m² në qendër të qytetit të jepen me qira për 2000€ në vit (më pak se 1€ m²). Ne kemi shumë shembuj: Lokalet e komunës që janë të palestra, për 40m² paguajnë qira 600€, ndërsa 2700m² po jepen në shfrytëzim për 170€ në muaj. Jemi pro investimit, por me këtë çmim që e keni caktuar si ekzekutiv po ndërhyri në punën e komisionit. Duhet të bëhet një rregullore e veçantë për pjesën e sheshit qendror që të trajtohet ndryshe sheshi, vlera e pronës që po jepet në shfrytëzim dhe e lokaleve, duhet të ketë çmim tjetër në krahasim me vlerën e pronave nëpër lagjet e tjera.

Jusuf Dërmala: Po ndërlidhem me temën e mëhershme, para se ta sjellni për diskutim në kuvend, duhet ta publikoni. Në 2025 ka qenë e publikuar kjo pronë e hotelit, por tani duhet për 2026. Drejtoreshë, nuk mundemi fillimisht ta diskutojmë në kuvend e tutje e publikojmë. Ligji e thotë që, fillimisht duhet ta publikosh e pastaj ta diskutosh në kuvend.

Besmire Bytyqi: Jusuf, nëse ne po bëjmë diçka në kundërshtim me ligjin, atëherë MAPL-ja do të na kthejë vendimet. Të lutem, jo me ironi dhe cinizëm. Ne do ta publikojmë listën dhe pastaj i njëjti vendim dërgohet në MAPL.

Isak Hoti: Në mungesë të drejtorit, më ra "hise" ta prezantoj këtë pikë të rendit të ditës. Me sa e di unë, është mbajtur debat publik për çështjen e hotelit dhe është diskutuar aty ndërtimin e një hoteli të ri. Në qoftëse ndërtohet një hotel i ri dhe shifrat e investimit janë milionëshe, konsideroj që kjo shifër ndoshta është shumë e madhe. Te pyetja e asambleistit te pjesa e parcelës, te pika 2 thotë: në sipërfaqe të përgjithshme 2793m, duke e përfshirë edhe objektin e Hotel Park Plazës, pra parcela në tërësi. Te Defrim Kafexhiu rreth realizimit të pagesës te pika e pestë, e cila thotë: pagesa fillon pas 24 muajve pas nënshkrimit të kontratës (grejs periudhë). Në momentin që ndërtohet hoteli brenda 24 muajve, edhe nëse nuk ndërtohet, ai obligohet të fillojë ta paguajë qiranë, përndryshe sanksionohet sipas ligjit. Jusuf, parcelat rifreskohen çdo vit dhe në këtë rast mundësinë për publikim e kemi deri më 31 mars.

Defrim Kafexhiu: Nuk është çështja e vlerës së qirasë, përfitimi më i madh i komunës është që po ndodh një investim. Këtu, në parim pajtohem, por po i jepni pak rëndësi pronës së komunës për një çmim kaq të lirë. Ne mund t'ia shtojmë edhe një pikë vendimit. Investitori mund të mos paguaj qira fare, por kur të përfundojë investimit, ai mund t'ia lë komunës 5 lokale (shembull). Qiraja mund të nxjerret prej këtyre 5 hapësirave afariste të gatshme. Mua si anëtar i

kuvendit, më intereson investimi në komunën e Rahovecit. Investitori paraparak i hotelit, sipas planit investiv i ka paraparë 2.6 milionë euro investim, pas 13 viteve është formuar një komision që ka shkuar ta vlerësojë vlerën e investimit në hotel dhe komuna pas 13 viteve e ka vërtetuar që ai nuk i paska investuar 2.6 milionë euro. Në fund ia shkëpusin kontratën. Pra, kjo vlerë e qirasë po e sjell këtë gjendje. Tani, me këtë qira, operatori është në gjendje që ta paguajë 15 vjet dhe në anën tjetër të mos investojë. Nga kjo pikë e shfrytëzoj rastin t'ia uroj ditëlindjen, drejtorit të Shëndetësisë, Afrim Oruçi.

Isak Hoti: Defrim, njoh shumë komuna që e kanë dhënë 1 ha për 1€. Qëllimi nuk ka qenë thithja e qirasë, por vetëm investimi dhe punësimi. Në rastin konkret, shumë i rëndësishëm është investimi. Nëse shkojmë sipas rregullores, i bie 5300€ muaji veç për parcelë. Te objekti një kat mund t'i ketë 1000m². Pra, qëllimi është punësimi dhe investimi. Kur e bëre krahasimin me objekte të tjera, objektet kanë qenë të gatshme, ndërsa këtu gjithçka do të fillojë nga themeli.

Enis Durguti: E kam veç një kërkesë. Më duket pak e paqartë puna e këtij hoteli, por besoj që komisioni na sqaron të gjitha këto. Kërkesa ka të bëjë me çështjen se, të gjitha raportet e komisioneve të na dërgoni, sepse si kuvend kemi të drejtë dhe është obligative t'i raportojnë kuvendit.

Kryesuesi: Faleminderit, Enis! Jam dakord me ty!

Isak Hoti: Enis, komisioni është i obliguar për raportim në kuvend, bashkë me vendimin, i cili bëhet i plotëfuqishëm për dhënien në shfrytëzim. Tutje, të gjitha gjërat e tjera i rregullon kontrata, sepse me votim ju e autorizoni kryetarin ta nënshkruajë kontratën. Ju si kuvend e keni në dorë, nëse dëshironi që komuna të inkasojë qira, ose e keni qëllim investimin.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Atëherë, ne si grup i LVV-së jemi të mendimit që qiraja të ngritët dhe tutje të vendoset në votim. Qiraja mujore 2000€ në vit është shumë pak, së paku 200/300 euro në muaj do të ishte më mirë.

Qazim Cana: Nuk mora përgjigje në pyetjen që e bëra rreth konstitucit gjyqësor dhe a ka bazë ligjore të vazhdojmë me procedurat e tenderimit?

Isak Hoti: Në bazë të listës poseduese, kjo pronë është e komunës dhe nëse hipotetikisht ka kontest gjyqësor, duhet të ketë edhe masë të përkohshme. Një gjë të tillë nuk e kemi dhe nuk jemi të informuar, pra parcela është e pastër rreth kësaj çështje.

Kryesuesi: E kam edhe unë një pyetje: Proceduralisht dhe ligjrisht vendimi a është në rregull, sa i përket çmimit dhe pikave të tjera?

Isak Hoti: Proceduralisht dhe ligjrisht jemi në rregull me këtë vendim. Sa i përket çmimit, ky kuvend e ka të drejtën ta jap me 1€, pa kompenzim, falas dhe sa të dojë.

Sali Sallteku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Një vit ia kishit dhënë falas, apo jo? Unë jam edhe një vit tjetër t'ia japim dhe mos të bëjmë hajgare me këtë çmim, sepse vërtetë është fyes. Më mirë e shtyejmë edhe një vit tjetër falas dhe e tutje diskutojmë prej A-Zh. Propozimi im duhet votohet, sepse është më i logjikshëm.

Defrim Kafexhiu: Propozoj që kjo pikë e këtij vendimi të largohet. Mos të hyjmë në lajthitje 27 anëtarët e kuvendit, për shkak të një propozimi që e ka bërë dikush prej ekzekutivit, apo prej zyrës ligjore që në këtë vendim të përfshihet edhe çmimi i qirasë. Këtë përgjegjësi duhet t'ia lëmë komisionit. Komisioni bën vlerësimin e ofertave dhe vendimi mund të bëhet edhe pa çmim hiç, sepse do të vlerësohet në oferta se kush po jep më shumë. Mirë e ka edhe kolegu baca Sali, më mirë falas se me këtë çmim!

Isak Hoti: Defrim, është mandati i dytë i juaji këtu dhe llogaris që këto gjëra fyese për zyrën ligjore nuk është mirë t'i thuash. Zyra ligjore nuk jep çmim. Zyra ligjore harton akte. Ne e kemi hartuar një akt me propozim të drejtorisë përkatëse.

Lirigzon Kastrati: Është e vërtetë që zyra ligjore propozimet i merr nga drejtoritë dhe e hartojnë aktin ligjor. Pajtohem plotësisht me idenë që çmimi i qirasë mos të përfshihet në vendimin e kuvendit, meqenëse është udhëzimi administrativ dhe rregulloret në fuqi që i përcaktojnë kriteret, atëherë përgjegjës për zhvillimin e procedurave është

vetëm komisioni. Konsideroj që kjo pikë duhet të hiqet. Sa i përket “grejs periudhës” është në rregull dhe pajtohem plotësisht.

Sali Sallteku: Unë e di që 24 muaj të fillimit e ka pa para, unë e thash që shtojani edhe 12 apo 24, por çmimi mos të përmendet, sepse është ofendues dhe jo i logjikshëm.

Berat Duraku: Faleminderit, kryesues! Te pjesa e çmimit: Ne e kemi një rregullore për dhënien e pronave në shfrytëzim, ku edhe jepet pragu minimal i çmimit, sepse procedurat i nënshtrohen ankandit publik. Në këtë rast, me këto propozime po e ulim pragu minimal apo jo? Ky vendim do t'i nënshtrohet përsëri ankandit publik dhe aty përzgjedhet oferta më e përshtatshme për komunën. Nuk e di a është kështu, apo nuk e kemi kuptuar drejt?!

Isak Hoti: Te ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale është i obliguar çmimi fillestar. Në këtë rast na e kemi çmimin fillestar dhe nën këtë çmim nuk guxojmë të biejmë. Çmimi fillestar në çdo ankand është dhe kush jep më shumë e fiton. Mirsad, nëse kemi harruar ktu ta shkrujmë, duhet ta bëjmë “se çmimi fillestar i pronës fillon nga 2000€”.

Kryesuesi: Ju falënderoj për shpjegimet! Si propozim i zyrës ligjore, pika e 4 le të bëhet kështu “çmimi fillestar fillon ...”. Po e vendosi në votim vendimit. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 15 vota “për” 11 kundër dhe 1 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Me pajtimin tuaj, shkojmë në pauzë deri në ora 12:30.

Kryesuesi: Atëherë u rikthyem në seancë. Nëse dakordoheni, tani e vendosim në diskutim pikën e cila lidhet me pikën e pestë të rendit të ditës, pra formimin e komisionit.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për plotësim-ndryshimin e vendimit 01Nr. 87/2026, i datës 20.01.2026 për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të Hotel Park Plazës P- 09038-2, ZK Rahovec:

Kryesuesi: Në këtë vendim, anëtarët e komisionit janë të njëjtë dhe ndryshon vetëm pika 1 e vendimit. Nëse nuk ka diskutues, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota pro miratohet ky vendim.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit nr. 36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 30m² (tridhjetë metra katrorë):

Besmire Bytyqi: Bëhet fjalë për lokalin në rrugën “Abdullah Bugari” me nr. 36, me certifikatë të pronësisë 004130-2 dhe jepet në shfrytëzim për 4 vite. Qëllimi: ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale.

Defrim Kafexhiu: Dua të përfshihem edhe një herë me debatin e mëhershëm, sepse besoj që është temë e njëjti. Pra, janë dy prona të komunës që do të jepen në shfrytëzim. Te kjo pikë, vendimin e së cilës e kemi para vetes, nuk ka çmim në asnjë pikë të vendimit. Pra, çmimi përcaktohet sipas rregulloreve, por mund të caktohet edhe nga anëtarët e komisionit përkatës. Po e vërtetoj një temë që e diskutuam rreth hotelit, ku ajo pikë të çështja e çmimit ka qenë e panevojshme.

Isak Hoti: Defrimin ia shpjegova edhe pak më herët se pse ka ndodh kjo. E diskutuam gjithashtu edhe këtu. Është e përcaktuar në rregullore se, në lokalet ku janë të rregulluara është i caktuar çmimi për metër katror (2 euro m²).

Kryesuesi: Nëse nuk ka diskutues të tjerë, këtë vendim po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 23 vota miratohet ky vendim.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, lokalit nr. 36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 30m² (tridhjetë metra katror), P-00413-2 ZK-Rahovec:

Besmire Bytyqi: Bëhet fjalë për formimin e komisionit për lokalin e njëjtë. Komisioni duhet të përbëhet nga 5 anëtarë, 2 prej tyre nga ekzekutivi, 2 nga legjislativi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

Berat Duraku: Nga AAK, propozojmë Feriz Thaqin!

Lirigzon Kastrati: Nga LDK, nuk kemi propozim!

Defrim Kafexhiu: Nga LVV, propozojmë Zana Qantën dhe pres mbështetje nga anëtarët e kuvendit.

Flutura Thaqi: Nga PDK, propozojmë Mirsad Shehun!

Kryesuesi: Meqenëse i kemi 3 propozime, duhet t'i vendosim në votim. Kush është "për" Feriz Thaqin?... Kundër?... Abstenime?... Kush është "për" Zana Qantën?... Kundër?... Abstenime?... Kush është "për" Mirsad Shehun?... Kundër?... Abstenime?... Feriz Thaqi dhe Mirsad Shehu me nga 15 vota, si dhe Zana Qanta me 9 vota. Nga kuvendi, në këtë komision janë: Feriz Thaqi (AAK) dhe Mirsad Shehu (PDK). Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 16 vota "për" miratohet ky vendim.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 dhe 2025, në vitin 2026:

Afrim Limani: Faleminderit, kryesues! Të nderuar drejtorë, ju asambleistë. Duke u bazuar në ligjin e buxhetit 2026, Drejtoria për Buxhet dhe Financa e ka përgatitur dokumentin mbi bartjen e mjeteve nga viti 2024 dhe 2025, në vitin 2026. Shuma që do të bartet është prej 621.000€. Në bazë të kësaj vlere e kemi përgatitur një dokument tjetër në formë tabelare, duke i futur edhe disa projekte të reja kapitale, të cilat kanë dalur sipas planit të prokurimit të përgatitur në dhjetor. I kemi edhe 5 projekte që janë në vazhdim dhe kemi menduar t'i zbusim obligimet kontraktuale që i kemi në kuadër të këtyre projekteve: Ndërtimi i sheshit qëndor, 100.000€, ndërtimi i rrugës Rahovec-Xërxë-Opterushë-Krushë e Madhe-Gexhë-Kramovik-Hoçë, 50.000€, projekte me bashkëfinancim, 100.000€, ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacion të autobusëve, 16.000€, ndërtimi i kolektorit të shtratit të lumit Hoçë e Madhe-Brestoc-Hoçë e Vogël-Nagac-Krushë e Madhe, 100.000€ dhe 255.000 i kemi paraparë duke marrë parasysh deficitin e krijuar nga viti i kaluar, sepse thesari me urdhër përmbarimor i ka tërhequr goxha disa mjete në mallra dhe shërbime dhe ne kemi munduar përafërsisht t'i mbulojmë.

Lirigzon Kastrati: I nderuar drejtor, në KPF e kemi diskutuar këtë pikë të rendit të ditës dhe më vjen mirë që e ke ndarë këtë shumë në projektin e shtratit të lumit, Hoçë e Madhe-Brestoc-Hoçë e Vogël-Nagac-Krushë e Madhe. Fillimisht janë ndarë 60.000€ dhe pata propozuar që, meqenëse mjetet e bartuar nuk lejohet të ndahen në projekte të reja, të përfshihen në projektet aktuale dhe po më vjen mirë që i ke ndarë 100.000€. Uroj që sa më shpejt të fillojnë punimet. Natyrisht, në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së, ne do ta përkrahim këtë bartje.

Defrim Kafexhiu: Këtu është një gabim teknik, te pika 2.5 dhe 2.6 është ndarë shuma e njëjtë. Një pyetje për drejtorin e financave: Pika 2.2, ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusëve në Rahovec. A është shuma që ka mbetur pa u paguar për projektin e vjetër të stacionit të autobusëve, apo ka ndonjë investim të ri?

Berat Duraku: E falënderoj ekzekutivin, bashkë me të gjithë zyrtarët për angazhimin e tyre në tejkalimin e të hyrave. Kjo gjë është shumë me rëndësi, duke e pasur parasysh gjendjen financiare të komunës. Gjithashtu, e falënderoj drejtorin, me të cilin kemi diskutuar në KPF që 50.000€ të mbesin në drejtorinë e Bujqësisë si subvencione për zhvillimin e projekteve.

Defrim Kafexhiu: Një vërejtje: Është mirë që po ndahen 50.000€ për bujqësi, por duhet ta kemi parasysh që nevoja për kulturë, rini dhe sport, sidomos është sport është e madhe. Të ndihmohet ndonjë klub që ka vështirësi financiare për ta tejkaluar sezonën.

Afrim Limani: Lirigzon, aq sa është ai projekt i rëndësishëm për ju, është njëjtë edhe për neve. Është projekt bazik dhe në bashkëpunim me kryetarin e kemi parë të arsyeshme të investojmë. Defrim, po është gabim teknik. Te pyetja e dytë rreth subvencionimeve në kulturë dhe sport: është vërtetë, por në këtë rast drejtoria e Bujqësisë ka pasur më shumë nevojë për subvencione, sepse mbi 50% e projekteve kapitale financohen nga subvencionet. Gjithësesi, do ta trajtojmë edhe pjesën e sportit.

Kryesuesi: Nëse nuk ka diskutues të tjerë, po e vendosi në votim këtë pikë. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 15 vota "për" miratohet ky vendim.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2026:

Kryesuesi: Plani është bërë prej anëtarëve të KKSB-së dhe është miratuar në KKSB. Formalisht kërkohet edhe votimi në kuvend. Fjala është për ju, nëse eventualisht keni diçka? Nëse jo, po e vendosi në votim këtë pikë. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 20 vota “për” miratohet plani i punës i KKSB-së.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Rahovecit 2026 – 2028:

Lendrit Qeli: Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit. Ky plan është hartuar në bazë të strategjive dhe rregulloreve shtetërore për integrimin dhe migrimin. Plani përqëndrohet në disa fusha kryesore: Identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të personave të riatdhesuar, referimin e tyre në shërbimet komunale-institucionale, mbështetje në punësim – mirëqenie sociale dhe arsim, si dhe koordimin ndër-institucional dhe bashkëpunim me donatorët. Është me rëndësi të theksohet se, plani nuk kërkon kosto shtesë nga buxheti komunal, sepse kompetencat janë në të centralizuara në nivelin qendror.

Defrim Kafexhiu: Sa janë rastet prej planit të kaluar të veprimt, të miratuar nga kuvendi i komunës që janë trajtuar nga ky mekanizëm dhe sa është efektiv ky plan?

Lirigzon Kastrati: Natyrisht në emër të grupit e përkrahim këtë plan, sepse komuna veçse është zbatuese e këtij plani.

Lendrit Qeli: Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim në kuandër të misionin të vet i ka 3 çështje kryesore: Çështja e komunitetit, riatdhesimi dhe kthimi. Meqenëse po flasim për riatdhesim, këtu kemi të bëjmë me personat që nuk e kanë statusin e rregulluar në shtetet të treta (Gjermani, Zvicër dhe shtetet e ndryshme të Evropës). Do të thotë që ne nuk mund të kemi informata se sa kthehen e sa jo, sepse kjo varet prej shtetit në të cilin qytetarët e Kosovës nuk e kanë një status të rregulluar. Në 3-mujorin e parë të këtij viti kemi rreth 7 raste të riatdhesimit, që kryesisht vijnë me probleme të ndryshme komplikative (prej masave të burgut – në Kosovë).

Kryesuesi: Nëse nuk ka diskutues të tjerë, po e vendosi në votim këtë pikë. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 23 vota “për” miratohet ky vendim.

12. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të draft-rregullores për Shërbime Publike 01 Nr.2917, i datës 26.10.2018:

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje drejtorë e drejtoresha, anëtarët të kuvendit, të pranishëm dhe monitorues. Para jush e keni draft-rregulloren për shërbime publike. Kjo rregullore ka kaluar në kuvend në vitin 2018, mirëpo asnjëherë nuk ka pasur ndryshime të kësaj natyre. Tani, kemi hasur në nevojë që duhet të kemi disa ndryshime në disa nene, me fokus kryesor në mbrojtjen e mjedisit.

Lirigzon Kastrati: E kam lexuar rregulloren dhe kryesisht ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit. Vërejtja që ndryshimet kryesore janë te gjobat. Uroj që drejtorja e Inspektoratit ta zbatojë këtë rregullore.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime, e kam një pyetje për drejtorin. A duhet të dalë në dëgjim publik kjo rregullore, ose ka qenë në dëgjim publik?

Përparim Krasniqi: Lirigzon, po, çdo nen e ka edhe pjesën e kundërvajtjes. Sa i përket diskutimit publik, nuk ka nevojë, sepse është plotësim-ndryshim i rregullores.

Jusuf Dërmala: E inkurajoj Inspektoriatin që të jetë më vigjilent dhe më shpesh në kontrolla, si dhe të dënohen ndotësit e ambientit. E përgëzoj drejtorin për këtë punë.

Kryesuesi: Faleminderit, Jusuf! Nëse nuk ka diskutues të tjerë, unë po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Me 20 vota “për” miratohet kjo rregullore.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë (objektit) te sheshi qendror:

Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! Të nderuar kolegë drejtorë, asambleistë dhe pjesëmarrës të tjerë në këtë seancë. Para jush e keni vendimin për dhënien në shfrytëzim, duke u bazuar në ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe ligjin për shfrytëzim dhe këmbim të pronave të paluajtshme të komunës. Ky është vendim për dhënien e pëlqimit paraprak për zhvillimin e procedurave të konkursit të hapur, për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës personit fizik apo juridik për 40 vjet, për ushtrim të veprimtarisë së biznesit përmes procedurës së shprehjes së interesit. Prona është te sheshi qendror me numër të parcelës 09038-3 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3399m². Në këtë pronë është edhe objekti (ndërtimi i vrazhdë). Kjo pronë jepet në ankand me vlerën fillestare 2200€. Realizimi i pagesës së qirasë bëhet 24 muaj pas nënshtrimit të kontratës. Në këtë pronë pas marrjes me qera, investimi parashihet të jetë rreth 1 milion euro, sepse përveç rregullimit të objektit parashihet edhe rregullimi i rrugës që lidh ish rrugën “Bajram Veliu” me rrugën “Xhelal Hajda” me trotuar dhe shteg për çiklistë. Kushdo që oferton për këtë parcelë do të kushtëzohen me këto kushte.

Defrim Kafexhiu: E kam një pyetje për drejtorin. Te dy parcelat, te kjo dhe te ajo e Park Plazës, a ka shpreh interes i njëjti operator? Apo e keni vlerësuar vet që kjo formë është më e mirë për dhënien në shfrytëzim, me një qira të ulët dhe që ata ta bëjnë investimin? Për çfarë çështje do të shfrytëzohet objekti i vrazhdë aktual? Çfarë do të bëjë aty, nëse një biznesmen e merrë atë objekt për 40 vjet? Cili është përfitimi i qytetarëve?

Lirigzon Kastrati: E ndryshoi drejtori, por më habiti vendimi në pikën 4, i cili thotë: çmimi i pronës komunale i cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të jetë 2200€. Do të thotë është caktuar çmimi, gjë që është në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës. Të gjitha këto kritere duhet t’i vendosë komisioni, i cili caktohet nga kuvendi. Prandaj, ky nen duhet të hiqet dhe të mos përcaktojë asnjë detyrim për komisionin rreth çmimit.

Jusuf Dërmala: Drejtor, nëse kjo parcelë dhe ky objekt ka qenë në planifikim të realizimit me sheshin qendror dhe në bazë të gjitha hartave të projektit ka qenë edhe pjesa e parcelizimit të asaj parcele. Siç dihet kjo hapësirë ka qenë e dedikuar për tregun ditor. Fillimisht, do të ishte më mire të ndodh finalizimi i projektit dhe tutje t’ia japim me qira individëve dhe jo njërit. Nëse veprohet kështu, ekonomikisht do të ishte më e arsyeshme.

Berat Duraku: Ne do ta përkrahim këtë pikë, me qëllim që aty të investohet. Çmimi aty është prag minimal dhe nuk do të thotë që pragu minimal është çmimi final me të cilin do të jepet me qira. E kam edhe një propozim: Propozoj që te i njëjti objekt të lejohet ndërtimi i lartë, në harmoni me dokumentet strategjike të aprovuara.

Albnor Mullabazi: Defrim, ankandi është i hapur dhe a është operatori i njëjtë apo jo, nuk mund të paragjykojmë. Në ankand, të drejtat janë të barabarta për të gjithë. Investimi do të jetë mbi 1 milion euro. Lirigzon, te pjesa e çmimit është lëshim Teknik, sepse duhet të jetë çmimi fillestar dhe kush jep qira më të madhe e merrë objektin. Jusuf, në fillim ka qenë si treg, por duke e ditur që tregu është të shtuneve në Rahovec dhe nëse realizohet në objekt të sheshit mund të ndikojë në demolim. Sa i përket tregut, së bashku me juve mund ta gjejmë një lokacion tjetër. Objekti në fjalë mund të jetë një qendër tregtare mjaft e mirë. Te pjesa e Berat Durakut: Po, objekti i plotëson kushtet për ndërtim më të lartë, por këtë mund ta vlerësojnë më mirë ekspertët e ndërtimtarisë. Ide e mirë.

Defrim Kafexhiu: Askush nuk është kundër investimeve në komunën e Rahovecit dhe është vendim i mirë që komuna kërkon forma të ndryshme për investime përmes objekteve dhe pronave të komunës, duke i dhënë me qira. Nëse e rregullorja e përcakton një çmim për një zonë të caktuar, është e paarsyeshme të vendoset një çmim minimal me vendim të kuvendit, jashtë çdo rregullore të Komunës së Rahovecit. Ju, jo që nuk po bazoheni me çmimin e ndonjë rregulloreje që e përcakton, por ne si kuvend i komunës do të detyrohemi që ta bëjmë një rregullore të veçantë për sheshin qendror, sepse do të kemi problem t’i menaxhojmë përmes rregulloreve aktuale për shkak të çmimit. Në këtë rast, ju po e vendosni çmimin minimal që është më i ulët se sa çmimi në rregullore. Po doni t’ia lehtësoni investitorit. Në vendim duhet ta shtojmë edhe një pikë, që t’ia caktojmë kriteret se në çka do të shfrytëzohet kjo sipërfaqe prej 33

ari. Investitori mund t'i investojë 1 milion euro, por investimin mund ta bëjë 100% për interes personal. Si kriter duhet të dihet edhe për sa kohë vlera e investimit do të përfundojë te kjo pronë? Nëse është puna te 1 milion euro, atëherë më mirë t'i investojë vetë komuna dhe ta shikojë vetëm interesin qytetarë aty, sepse përndryshe mund të ndodh që prona të bllokohet për 40 vjet, për shkak të këtij investimi prej 1 milion euro! Përfundimisht, duhet të ketë afat kjo vlerë e investimit brenda 1 ose dy viteve, nëse jo, duhet t'i shkëputet kontrata këtij që e fiton ankandin. Unë jam kundër dhe propozoj që çmimi të largohet. Me këtë çmimi i bie që metri² të jetë vetëm 50 centë dhe kjo është kompetencë e komisionit, jo e kuvendit. Gjithashtu, besoj që MAPL-ja do t'i kthejë të dyja vendimet, këtë dhe atë të parkut, sepse si kuvend nuk po e llogarisim asnjë rregullore dhe po e caktojmë një çmim. Kjo lidhet edhe me shumicën e votave në kuvend dhe nuk bën që t'i keqpërdorni. Në këtë mandat, mungon arsyeja dhe dominon fuqia e votës që e keni ju. Në fund, janë qytetarët ata që do t'ju gjykojnë. Nëse njëmend po punoni në interes të tyre, atëherë kjo nuk është interes qytetar. T'i jepni 33 ari në vlerë prej 2200€ vjetore është hajgare, sepse në anën tjetër një lokal me 30m² paguan 700€ qira mujore. Propozoj që ta largojmë këtë kriter, pikën e katërt. Përndryshe, le të jetë përgjegjësi e atyre që e votojnë vendimin, në këtë formë dhe me këtë çmim minimal.

Lirigzon Kastrati: Dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në afat prej 15-99 vite bëhet përmes shprehjes së interesit. Njoftimi për shprehje të interesit i përcakton kriteret që do t'i vendosë komuna. Njoftimi publik për shprehje të interesit zgjat 15 ditë dhe përfshin: emërimin, përshkrimin, sipërfaqen, destinimi dhe lokacionin e pronës që jepet në shfrytëzim. Pika 2 - afatin e dhënies në shfrytëzim të pronës, pika 3 - veprimtaria që mund të ushtrohet sipas destinimit të pronës, pika 4 – afatin e fundit për aplikim, pika 5 – vendin ku bëhet pranimit i ofertave për shprehje të interesit, pika 6 – dorëzimi i ofertave në formën e mbyllur përmes qendrës për shërbim të qytetarëve (me protokol) dhe pika 7 – numri kontaktues dhe informacionet shtesë të ofertuesit. Pra, askund nuk përmendet çmimi fillestar. Drejtori tha që lejohet, kjo është joligjore. Me përgjegjësi të plotë e them që nuk mund ta vendosësh çmimin fillestar, sepse kriteret i përcakton rregullorja. As kuvendi komunal nuk mund ta përcaktojë çmimin fillestar.

Jusuf Dërmala: Objekti është jetik për vendin, qytetin dhe sheshin. Finalizimi i sheshit së bashku me objektin dhe pas parcelizimit do të mund të përfitojnë 20 subjekte apo edhe më shumë. Mendoj që fillimisht sheshi së bashku me këtë objekt duhet të finalizohet dhe tutje të vazhdojmë me procedurat e dhënies me qira.

Lirigzon Kastrati: Mesiguri zyra ligjore ose drejtorja i kanë ngatëruar kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në afat prej 1-15 vite. Pra, në këto kritere lejohet çmimi fillestar, por nëse është në afat 40 vite, atëherë nuk lejohen këto kritere.

Isak Hoti: Çmimi fillestar është parim ligjor i obliguar në afatshkurtë dhe afatgjatë. Te neni i 4, te parimet: dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet duke u bazuar në këto parime: Parimi i ligjshmërisë, parimi i efikasitetit, që nënkupton se organet e komunës ia fillojnë procedurën për dhënien në shfrytëzim, parimi i trajtimit të barabartë, parimi i transparencës dhe parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës. Do të thotë që, çmimi fillestar mund të jetë edhe 1 € dhe për këtë arsye është në ankand publik. Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës është përgjegjës të sigurojë konkursin e hapur, të mbetet në përputhje me procedurat e kësaj rregulloreje, të sigurojë që dokumentet të jenë në dispozicion të pjesëmarrjes së konkurrimit, të sigurojë që konkursi është i shpallur me ueb-faqe dhe të sigurojë konfidencialitetin. Pra, komisioni do ta përfundojë 90% të punës, duke përfshirë kriteret dhe çmimin. Neni 20 thotë: Zgjedhja e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë bazohet në këto kritere: oferta ekonomikisht më e favorshme e përfshin vlerën e investimit, numrin e të punësuarve nga investimi, llojin e investimit që është në interes publik, përfitimi financiar ekonomik dhe kriteret e tjerë që përcaktohen me konkurs.

Kryesuesi: Faleminderit! Një pyetje: Kush i investon këto 1 milion euro, komuna apo ai i cili do ta merr punën?

Albnor Mullabazi: Investimin do ta bëjë personi që e fiton ankandin. Defrim, një gjë duhet ta kuptosh, pas këtij vendimi formohet edhe komisioni. Anëtarët e komisionit e kanë besimin e juaj për atë edhe i delegoni, sepse këta i vendosin kriteret dhe kushtet. Nëse nuk i besoni komisionit, atëherë mos e formoni fare. Te Lirigzoni, sa i përket

interpretimit ligjor, këtu e kemi zyrën ligjore dhe mund t'ju informojë. Te Jusuf Dërmala, pajtohem me idenë e finalizimit të sheshit, por pse jo të provojmë ta nxjerrim një investim të madh mbi 1 milion euro dhe t'ia kursejmë komunës të njëjtat. Interesi i komunës është që ta tërheqim ndonjë brend të ri, që mund të ndikojë për të mirë në të gjithë komunën tonë. Kërkoj mbështetjen tuaj për këtë pikë.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! E vlerësoj këtë hapësirë për diskutim edhe pse nuk është e përcaktuar me rregullore. Po i drejtohem shefit të zyrës ligjore dhe zyrtarit tjetër të zyrës ligjore. Ne mund të diskutojmë politikisht, por qytetarët juve iu kanë dhënë besimin dhe ju e mbani përgjegjësinë e çështjeve kryesore. Në foltore doli shefi i zyrës ligjore dhe i lexoi disa nene, të cilët nuk kanë lidhje me vendimin që po e votojmë sot dhe kjo gjë për mua të paktën është e papranueshme. Mund të të vlerësoj në aspektin e njohurive juridike, por jo të tentosh me një formë të na mashtrosh prej foltores si anëtarë të kuvendit. Në asnjërin prej neneve që i përmende nuk përmendet çmimi fillestar. Nëse është obligim që ta caktojmë çmimin këtu, atëherë pse në vendimin afatshkurtër të një prone tjetër paraprake, nuk e përcaktuam çmimin sipas vendimit. Nëse duhet ta jepni me 50 centë m² në shesh qendror, atëherë mbajeni ju përgjegjësinë si ekzekutiv dhe jo ne si kuvend. Gojarisht po e përmendni si çmim fillestar, por këtu te pika e 4 thotë: “çmimi i pronës komunale i cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të jetë 2200€ në vit”. Këtu thuhet se sa do të jetë çmimi dhe jo ai fillestari dhe ndonëse gojarisht e the që është fillestari, ne po e votojmë një vendim me çmim fiks. Unë propozova që të largohet çmimi nga vendimi. E ftoj kryesuesin që ta vendosë në votim propozimin tim. Te sheshi qendror nuk është publik asnjë projekt detal. Qytetarët kanë nevojë ta dinë se çka po bëhet te sheshi qendror dhe si do të duke ai final. Mendoj që duhet të mbahet edhe një konsultim publik rreth shfrytëzimit të atyre pronave, që në fund të dalim sa më mirë në interes të qytetarëve. Kryesues, respekt! E di që e keni shumicën dhe mund të na mbyllni edhe propozime edhe mendimet në formën e votimit, por nuk është e drejtë, sepse jemi këtu për interes të qytetarëve dhe jo të dominojë fuqia e votës.

Kryesues: Sa i përket punës së votave, në mandatin e kaluar si pozitë nuk i kishim numrat, i kishit ju. Në atë mandat ju e keni bërë demokracinë dhe tani nuk po pajtoheni me këtë demokracinë e re. Nuk kam çfarë t'ju bëjë, sepse është vota e qytetarëve që i përcakton këto kritere.

Albnor Mullabazi: Defrim, e thash edhe në fillim dhe përsëri kërkoj që të përmirësohet dhe të bëhet “çmimi fillestar fillon me 2200€”. Te pjesa e diskutimit publik për sheshin: Në vitin 2019 sheshi ka qenë në konkurs ndërkombëtar dhe është mbajtur diskutimi publik. Tani projekti është votuar, është publik në ueb-faqen e komunës dhe në rrjetet sociale.

Isak Hoti: Defrim, në lajthitje nuk e vendosi askënd, sepse e kemi ligjin dhe rregulloren, akte të cilat e rregullojnë çështjen e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale. E dyta, fjalën mashtrim mbaje përveti, sepse unë jam veç një shërbyes civil. Ti dhe krejt kuvendit mund të na akuzoni të gjithëve, por ne e bëjmë një punë sipas kërkesave. Nëse ke diçka individuale me Isakun, këtu jam. Nëse ke diçka për çështje pune, prapë jam këtu.

Kryesuesi: Temat që i trajtojmë, kryesisht janë për interes të përgjithshëm dhe për çështje personale ju ftoj për qetësi, si dhe të gjitha muhabetet mund t'i zgjidhni jashtë.

Jusuf Dërmala: Në dhënien e kësaj prone, gjithësesi duhet ta shikojmë arsyeshmërinë ekonomike. Ky qëllim është esenca e krejt kësaj. Nuk e di pse nuk finalizohet fillimisht dhe tutje të jepet në shfrytëzim, sepse të hyrat për komunën do të ishin më të mëdha. Te demokracia: demokracia thotë që jodomosdoshmërisht duhet të na ndërprehsh fjalën, sepse nëse ti nuk flet, atëherë unë duhet të flas. Realisht, ju me kryetarin po pajtoheni për çdo gjë dhe kjo i bie që nuk jeni në demokraci, por në autoritarizëm.

Kryesuesi: Nëse do të ishte ndryshe, ndoshta do të fitonte ndonjë parti tjetër politike. Qytetari e ka vlerësuar këtë vazhdimësi dhe demokracinë varet si e interpretoni dhe si e kuptoni. Rregullorja ta përcaton se sa herë ke drejtë të flasësh dhe në çfarë minutazhe. Unë jam shumë tolerant, por kur e tepron jam i detyruar të të ndërprejë ty, 26 të tjerët dhe secilin. Për shkak të kësaj demokracie, këtë vendim po e vendosi në votim.

Berat Duraku: Unë kam propozuar që në objekt të lejohet ndërtimi edhe me etazhitet më të lartë, në harmoni me planet strategjike të komunës.

Kryesuesi: I kemi dy propozime, të Beratit për ndërtim të lartë të objektit, si dhe të Defrimit për largimin e pikës numër 4. Kush është “për” propozimin e Beratit?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota “për” dhe 4 kundër, miratohet propozimi i Beratit për vazhdim të ndërtimit mbi këtë objekt. Kush është “për” propozimin e Defrimit për largimin e pikës së 4 nga vendimi?... Kundër?... Abstenim?... 10 “për”, 14 kundër dhe asnjë abstenim, pika e 4 mbetet në këtë vendim. Si tërësi po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Miratohet vendimi, me 14 vota “për”, 10 kundër dhe asnjë abstenim.

14. Shqyrtimi dhe miratimi vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës:

Albnor Mullabazi: Para jush e keni vendimin për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës. Komisioni përbëhet prej 2 anëtarëve të ekzekutivit, 2 prej kuvendit dhe 1 nga sektori joqeveritar. Këtu e keni mundësinë që përmes anëtarëve të komisionit t’i vendosni kriteret për pikën paraprake.

Kryesuesi: Në dakordim me juve, përmes sekretarisë së kuvendit po e autorizojmë kryetarin që t’i përzgjedh 2 anëtarë nga ekzekutivi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

Berat Duraku: Nga AAK, në mënyrë shumë demokratike e propozojmë, Mentor Durgutin.

Lirigzon Kastrati: Nga LDK, në mënyrë shumë demokratike nuk pajtohem me këtë komision dhe me vendimin paraprak. Nuk kemi propozim.

Zana Qanta: LVV nuk ka propozim për këtë komision.

Flutura Thaqi: Nga PDK propozojmë, Behlul Krasniqin.

Kryesuesi: Meqenëse i kemi dy propozime, nuk ka nevojë të shkojmë më tutje, vetëm se po e vendosi vendimin në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Me 14 vota “për”, 4 kundër dhe asnjë abstenim, miratohet vendimi.

15. Shqyrtimi i informatës së DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025-2026:

Muhamet Morina: Faleminderit, kryesues! Të nderuar kolegë drejtorë të drejtorive, shumë të respektuar asambleistë. Para jush e keni materialin nga DKA-ja, si informatë për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2025-2026. Për këtë material nuk dihem shumë kompetent, nuk ka ndodh në kohën time, sepse unë jam emëruar më vonë. Megjithatë, jam munduar t’i paraqes të dhënat në lidhje me planin vjetor të DKA-së, në bazë të të cilit i ka kryer përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026, si dhe për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor. DKA-ja është bazuar në tri shtylla: Përgatitja infrastrukturore për fillimin e vitit të ri shkollor, regjistrimi i nxënësve në klasë të para, të dhjeta dhe në shkollën profesionale, si dhe plotësimi i vendeve të punës në bazë të planifikimeve që drejtorët e shkollave i kanë dorëzuar në DKA. Me shifrat të nxënësve të regjistruar nuk po ju lodhi, sepse i keni të shënuar në informatë. Do të ndalem në numrin e përgjithshëm të nxënësve. Në çerdhe dhe parafillor janë 879 nxënës, klasa e parë dhe e nënta 5143 nxënës, klasa e 10-të deri në të 12-tën janë 996 nxënës. Në total janë 7018 nxënës. Në seancën e kaluar, asambleisti Lirigzon Kastrati i ka parashtrua disa pyetje, profesor Sali Sallteku dhe asambleisti Behlul Krasniqi. Profesor Sali, kërkesa juaj është realizuar dhe tanimë është në shqyrtim e sipër te drejtorja e Gjeodezisë dhe Kadastrës, ndërsa te Behluli gjithashtu i kemi marrë paramasat e objekti i asaj shkolle, pra të punëve që duhet kryhen dhe në një kohë të afërm do të përfundon puna aty. Te Lirigzon Kastrati, i cili ma ka bërë këtë pyetje: Të na njoftojë drejtori i Arsimit, si përfaqësues i kësaj drejtorie se ku janë mungesat e kuadrit profesional, të matematikës dhe fizikës? Të na njoftojë për gjendjen e mësimdhënësve me normë të plotë, si dhe ata me gjysmënormë. Sipas informacioneve nga ekzekutivi mbi 186 mësimdhënës më tepër dhe këtu po e shohim që për arsimin fillor komuna ka shpall konkurs! I nderuar asambleist, jam shumë i kënaqur me pyetjet tuaja dhe unë jam munduar që t’i përgjigjem të gjithave. Te pyetja e parë: Janë 13 vende pune që mundojnë matematicientën e kualifikuar, ndërsa për fizikë këtë vit nuk kemi mungesë, por kjo nuk do të thotë që për vitin tjetër nuk do të kemi.

Pyetja e dytë: Në arsim është një formulë përmes së cilës llogaritet raporti nxënës-mësidhënës dhe në bazë të kësaj formule e shohim se a kemi tepër mësimdhënës apo jo. Raporti mësimdhënës-nxënës në shkollat fillore dhe të mesme është 1 mësidhënës me 21.3 nxënës, ndërsa te minoritetet është 1 me 14. Pra, këtu është arsyeja që i kemi të mbipopulluar shkollat me mësimdhënës. Prej datës 5 janar jam në DKA dhe deri më tani kemi arritur që në 5 vende pune të mos shpallim konkurs për shkak të pensionimit, por orët i kemi shpërndarë te mësimdhënësit e tjerë dhe pa asnjë problem po vazhdon zhvillimi i mësimi. T'ju them të drejtën, e kam gati një reformë për sistemin tonë arsimor e cila nuk varet krejt prej nesh. Me udhëzim administrativ, çdo shkollë që i ka nën 100 nxënës e humb statusin e shkollës së pavaruar dhe duhet të shndërrohet në një shkollë paralele të ndarë, e cila automatikisht mbetet pa drejtor. Këto reforma do të jeni të dhimbshme dhe nuk kemi ku të shkojmë, duhet të ballafaqohemi me realitetin. Ka mësimdhënës me nga gjysmë norme dhe fizikisht qëndrojnë në listë të pagave, por në fakt nuk kanë obligime buxhetore dhe numri prej 186 mësimdhënës më tepër bie. Faktor tjetër i këtij numri prej 186 është edhe që, në lista të pagave qëndrojnë edhe mësimdhënësit që marrin pushime pa pagesë, ndonëse paga e tyre është zero zero. Fatmirësisht në programin fillor rreth 90% e personalit është me mësimdhënës dhe fatmirësisht ato po lindin e në vendet e tyre duhet patjetër zëvendësim dhe kjo është arsyeja pse ne shpallin konkurse. Sa i përket kuadrove: Këtu e kam listën e mësimdhënësve të matematikës që nuk janë profesionistë të kualifikuar, më lartë e ceka që janë 13 sosh. Ka prej tyre inxhinierë e ekonomistë. Unë kam menduar që nga shtatori këto vende të lira me profile deficitare t'i plotësojmë me mësidhënës të programit fillor. Mësimdhënësi i tillë është ai që e ka kryer pedagogjinë, provime të metodikës dhe matematikës, si dhe me një përgatitje të vogël në shtëpi do të jenë në gjendje ta kryejnë detyrën si mësimdhënës të matematikës. Meqë Vetëvendosja e ka pushtetin qëndor, përmes kolegëve të mi në kuvend, kam menduar që t'i drejtohem ndonjë deputeti që e ka fuqinë e votës dhe t'i kërkojmë që në universitetin e Prizrenit dhe të Gjakovës të hapen drejtimet e matematikës dhe të fizikës. Me këtë veprim mund të eliminohen këto telashe deficitare. Ideja tjetër është mësimdhënësve profesionistë t'ju shtohen orët e profileve deficitare, me pagesë kuptohet. Në qoftëse dëshirojmë t'i stimulojmë më shumë nxënësit, ideja është që të rriten bursat për nivele shkencore. Ju njoftoj që, prej që jam unë drejtor i Arsimit, e kemi bërë një plan të veprimit për pedagogët dhe ata tanimë janë duke i frekuentuar shkollat. Në javën që shkoi, nga departamenti i psikologjisë në fakultetin filozofik kam kërkuar të na mundosojë që studentat e masterit të këtij departamenti t'i kryejnë praktikat profesionale në shkollat tona dhe pa implikime buxhetore mund t'i mbulojmë shkollat me pedagogë dhe psikologë.

Sali Sallteku: E përshëndes drejtori dhe e falënderoj për projektin tim të propozuar. Gjërat politike në arsim, fatkeqësisht udhëheqen nga lart dhe fatkeqësisht nuk kanë bërë asgjë. Është gjynah i zotit që e ka udhëhequr 5 vjet ministrinë e Arsimit, tanimë shefja e deputetëve të VV-së. Është krim! Atë që e ka drejtorin për 100 nxënës. Vetëm në komunën e Rahovecit janë mbi 9 shkolla satelit, por janë 3-4 që ky drejtor nuk ka faj, por që i kemi pavarësuar në kohën tonë, që ka qenë gjithashtu gabim. Nuk është mirë që klasa t'i ketë nën 12 nxënës. Unë e di shumë mirë që në komunën tonë ka edhe me 1 ose 2 nxënës. Qëndron Kastrati u mundua ta bëjë reformën e tij, por e hoqi VV-ja e shkatërroi.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Duke u bazuar në raportin e DKA-së i kam vërejtur si mangësi, por për shkak të respektit ndaj drejtorit do t'i quaja më mirë si mosplotësim i duhur i informatave, sepse këto punë i kanë takuar ish-drejtorit. Në raport thuhet se janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, megjithatë kjo në praktikë nuk ka qëndruar, me vetë faktin që stafi mësimor është ftuar në mbledhje ditën e premtë e mësimi ka filluar ditën e hënë, tregon se nuk ka pasur përgatitje të mjaftueshme për një fillim të suksesshëm të vitit shkollor. E kam lexuar raportin me kujdes dhe nuk e kam hasur që të përmenden vështirësitë reale me të cilat janë përballur disa shkolla: problemet me menaxhimin dhe ndërprerjen e procesit mësimor për shkak të mungesës së ngrohjes. Konsideroj se raportimi i saktë i gjendjes në terren është thelbësor për t'i adresuar sfidat dhe për ta përmirësuar cilësinë e arsimit. Drejtor, e përmende raportin mësimdhënës-nxënës në shkollat fillore dhe në cilket më të larta. Nëse ka mundësi një informatë më të detajuar se si qëndron ky raport në çerdhen në qytet dhe në të tjerat?!

Lirigzon Kastrati: E falënderoj drejtorin për përgjigjet e tij. Një raport i tillë i detajuar na ka munguar edhe në seancat e viteve të kaluara. Është mirë kur merresh dhe e identifikon problemin, atëherë edhe zgjidhja është më e lehtë. Pajtohem plotësisht me propozimin që të rriten bursat për profilin e matematikës dhe fizikës. Kërkoj gjithashtu nga DKA që t'i rritë bursat për këto dy kategori. Një pyetje: A ka pasur vështirësi ndonjë shkollë që nuk ka qenë gati për fillim e vitit të ri shkollor? Sa i përket kuadrit deficitar, i keni dhënë disa propozime, por a mund të konsiderohet rikualifikim i kuadrove ekzistuese të ekonomistëve dhe inxhinierëve, që tanimë janë në sistemin tepricë që ofrojnë asistim në matematikë?

Defrim Kafexhiu: Në mandatin e kaluar e kam bërë një propozim për ndryshimin e shpërndarjes së bursave për studentë, si një formë më produktive në mbështetjen e profileve deficitare. Komuna t'i mbështesë 100% nxënësit që studiojnë këto profile. Ky propozim nuk është marrë parasysh edhe pse kryetari ka shpreh interes ta dëgjojë propozimin dhe ta ketë të shkruar. Shpresuam që do ta fitonim komunën dhe ta realizonim propozimin, por meqenëse jemi në një situatë tjetër dhe jemi në fillim të ciklit buxhetor, unë përsëri do ta bëjë propozim edhe në formë të shkruar. Shuma mund të jetë minimale, duke filluar me 20.000€ nga ana e subvencioneve dhe në vitin e parë ta kemi si pilot-projekt. Në raportin e drejtorit nuk e vërejtja që është raportuar edhe për sjelljen e nxënësve, si dhe për gjendjen e shkollave rreth çështjes së mungesave të nxënësve. Sa janë efektive transferet e nxënësve, kur ndodhin për shkak të mungesave të nxënësve? Të rekomandoj ta plotësosh raportin edhe me këtë çështje. Të mundohemi bashkërisht ta ulim numrin e mungesave dhe ta rrisim pëlqyeshmërinë e vijueshmërisë së nxënësve nëpër shkolla.

Lirigzon Kastrati: Te çështja e mungesës së nxënësve dhe mësimdhënësve: në vitet paraprake kam kërkuar çdo herë të dhëna rreth kësaj çështjeje. Një herë drejtori i Arsimit më ka dërguar të dhëna, por veç e veç për secilën shkollë dhe e kisha problem t'i grumbulloja. Më intereson ta di që nga viti te viti pasues, a kemi rënie të mungesave të mësimdhënësve dhe nxënësve?

Bujar Mustafa: Këto reforma besoj që do të marrin kohë për realizim, për shkak të procedurave ligjore dhe gjërave të tjera. Në disa shkolla e kam vërejtur që nxënësit rrezikohen edhe nga problemet me nyje sanitare. Besoj që është shumë e rëndësishme të intervenohet sa më shpejt. Për kolegun atje, këto gjëra i rregullon komuna dhe jo qeveria. Ruatja e shëndetit publik për nxënësia është shumë e rëndësishme.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Po ndërlihem me kolegun, Bujarin! Nëse ka mundësi që të bëhet një intervenim sa më i shpejtë te shkolla "Gëzim Hamza – Piktori", ku nyjet sanitare janë në gjendje të mjerueshme, por aty ka probleme edhe me kanalizim.

Sali Sallteku: Nuk i thash asgjë këtij djalit, nuk ka arsye të bëhet nervoz. Unë i tregova drejtorit që e ka shumë të vështirë punën me këtë qeveri dhe me këtë ministri. Për ato 5 vjet, as lavrën e miut nuk e ka bërë ajo e juaja.

Muhamet Morina: Do të përpiqem të përgjigjem sinqerisht! E falënderoj profesorin Sali Sallteku për mbështetjen e tij, sepse ka përvojë në menaxhim të arsimit dhe këshillat e tij janë të mirëseardhura. Te Vlora Vuçiterna: Raporti në çerdhe është 1 me 12. Në Rahovec çerdhja është e mbipopulluar, në Ratkoc vazhdon të rritet numri (50 fëmijë), në Xërxë është shumë mirë, ndërsa në Krushë që gjendje çalon (30 fëmijë) ndoshta edhe për shkak të lokacionit. Te Lirigzoni dhe Defrimi për mungesat e nxënësve, të cilën do ta përgatisë saktë për mbledhjen e radhës. Për nyjet sanitare e kemi një kontratë me një operator, i cili është duke i marrë masat në shkollat që kanë nevojë dhe brenda mundësive tona nuk do të lëmë gurë pa lëvizur që këto çështje t'i rregullojmë. Sa i përket kualifikimit të mësimdhënësve: Ligji e thotë që, mësimdhënësi i kualifikuar për klasët 1-9 duhet t'i ketë 240 kredi, ose 180 plus 120 master. Sa i përket sjelljeve të nxënësve nëpër shkolla, është normale që nuk jemi të kënaqur me këtë çështje. Sa i përket mungesave, në shkolla të mesme ka masa (transfer për një muaj), gjë që nuk është shumë efektive, ndërsa në shkollat fillore nuk ka masa për mungesa, por vetëm një bashkëpunim me prindërit. Këto janë përgjigjet! Në projektet tona, pres mbështetje nga të gjitha grupet politike.

16. Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2025:

Astrit Mullabazi: Përshëndetje për të gjithë! Raporti vjetor i kontratave të nënshkruara publike është përgatitur më 26 janar 2026. Sipas planit të prokurimit për vitin 2025 i kemi zhvilluar 45 aktivitete të prokurimit, me vlerë të parashikuar 15.497.319€. Kontrata gjithsej janë nënshkruar 40 për punë, furnizime e shërbime. Vlera e kontratave është 15.157.106€ dhe 5 aktivitete të prokurimit për vitin 2025 janë anuluar.

Lirigzon Kastrati: Sot po e diskutojmë një nga raportet më të rëndësishme të funksionimit të komunës, raportin vjetor për kontratat e nënshkruara përgjatë vitit 2025 me vlerë mbi 15 milionë euro. I kam disa pyetje: A janë investuar këto mjete sipas prioriteteve reale të qytetarëve? Cilat janë arsyet e anulimit të kontratave?

Astrit Mullabazi: Vlera e kontratave të nënshkruara për vitin 2025 është 15.157.106.91€. Ndërsa tri aktivitete të prokurimit janë të financuara nga ministria e Infrastrukturës dhe procedurat e prokurimit i ka zhvilluar Komuna e Rahovecit. Vlera e këtyre tri aktiviteteve është 12.134.877.28€: projekti i asfaltimit të rrugës Rahovec-Drenoc-Senoc-Pastasel-Polluzhë, ndërtimi i rrugës me 4 korsi dhe ndërtimi i rrugës nga rrethrotillumi i ri deri te dalja në rrugë për Xërxë. Vlera e projekteve të nënshkruara nga Komuna e Rahovecit është vetëm 3.022.000€. Sa i përket anulimit të 5 aktiviteteve të prokurimit: janë anuluar me arsye që, p.sh.: servisimi i aparateve për shuarjen e zjarreve është anuluar, sepse të gjithë tenderat e përgjegjshëm përmbajnë çmimin që e tejkalon buxhetin e autoritetit kontraktues – vlera e ofertuar ka qenë më e madhe sesa vlera e parashikuar e komunës. Anulimet e tjera janë bërë për shkak të përbaruesit, e kemi zhvilluar aktivitetin, por nuk kemi mundur ta nënshkruajmë kontratën për shkak të çështjes përbarimore.

Defrim Kafexhiu: Dëshiroj ta citoj Astritin dhe të dëgjojnë kolegët e PDK-së. Tri kontrata të nënshkruara në vlerë prej 12 milionë euro janë financim nga ministria e Infrastrukturës, qeverisë së LVV-së. Nuk është vetëm zi e terr. Një pyetje për Astritin: A ka kontrata që janë në proces gjyqësor, ose kontratat që janë aktive dhe janë në proces gjyqësor.

Astrit Mullabazi: Për vitin 2025 nuk ka kontrata që janë në procedurë gjyqësore. Prej 45 aktiviteteve për vitin 2025 asnjë nuk ka qenë në OSHP.

Kryesuesi: Faleminderit! Meqenëse në pushtet e kemi Vetëvendosje, i inkurajoj asambleistët e VV-së që sa më shumë projekte të kërkojnë për komunën e Rahovecit.

17. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës, 71510057-02240-80, ZK Rahovec:

Kryesuesi: Ky është vendim që është kthyer prej MAPL-së ku e kontestojnë vetëm preambulën. Në preambulë duhet të ceket edhe një ligj dhe është rregulluar tanimë. A kemi diskutues për këtë pikë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 19 vota “për” miratohet ky vendim.

18. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

Vlora Vuçiterna – Çmega: Përshëndetje edhe një herë! Këtu nuk e kemi as kryetari e as drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, por megjithatë besoj që e marrin propozimin dhe e shqyrtojnë. E një propozim në përmirësimin e shërbimeve në pedodonti (stomatologjia për fëmijë). Duke pasur parasysh që ky shërbim funksionon me orar nga ora 08:00-15:00, ka vështirësi të theksuara në ofrimin e shërbimeve pas orës 12:00. Kjo ndodh, sepse procesi i sterilizimit të instrumenteve në stomatologji realizohet me sterilizues të modeleve të vjetra. Këtu e kemi edhe doktorin dëshmitar. Kjo gjendje kërkon kohë më të gjatë për përpunim. Si pasojë, bëhet i shterpë pranimi dhe trajtimi i fëmijëve në stomatologji pas orës 12:00. Kjo problematikë më shumë është për fëmijët, të cilët e vijnë mësimin paradite. Për këtë arsye propozoj që, Drejtoria e Shëndetësisë ta sigurojë një autoklavë moderne, pajisje kjo që kushton rreth 1500€. Përfitimet do të ishin të shumëfishta: shkurtimi i kohës së sterilizimit, rritja e efikasitetit dhe sigurisë në punë, mundësia e ofrimit të shërbimeve deri në ora 15:00 pasdite, përmirësimi i shërbimeve, si dhe rritja e cilësisë. Shpresoj që propozimet e tilla që po i bëj, do të merren parasysh edhe pse jemi opozitë, meqenëse janë për të mirën e qytetarëve.

Mentor Veliu: Faleminderit, kryesues! Drejtorë të nderuar dhe kolegë asambleistë. Dua t’i diskutoj 2-3 çështje, por njëra më me rëndësi është qendra e qytetit. Qendra po na shqetëson secilin që jetojmë këtu, por edhe ata që e frekuentojnë. Duhet ta shohim mundësinë se si mund të rimodelohet kjo qendër dhe ta bëjmë një zgjidhje për shkak

të banorëve dhe bizneseve që po iu shkaktohet humbje secilën ditë. Mendoj që duhet ta bëjmë një zgjidhje me cilëndo drejtori përkatëse. Nuk është zgjidhje kjo që është për interesa të caktuara, apo nga mosdija e dikujt, që është bërë ai projekt në të kaluarën. Një parcelë që është në mes të qytetit, do të ishte ideale për një shtëpi të pleqve. Prona është e komunës dhe gjendet në rrugën “Ali Sokoli” dhe dita e ditës po uzurpohet nga banorët aty, duke u ngushtuar nga e majta në të djathtë, e nga posht e lart. Njëkohësisht është edhe një pronë e uzurpuar të “Rrasat” e Rahovecit, që e lidh rrugën të Agroferi me lagjen e serbëve. Në atë vend, propozoj që ta krijojmë një formë “ode” që mund të na shërbej për të pame. Është një aneks të muzeu i qytetit, ku nuk i shërben askujt e që mund të na hyjë në punë për të njëjtën gjë.

Hazbije Shala: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryesues, drejtorë, kolegë asambleistë dhe të dashur qytetarë. Dua të flas për disa shqetësime serioze që lidhen me infrastrukturën rrugore në zonën tonë. Rruga në hyrje të fshatit Zoqisht është në gjendje të rënduar tash e disa vite dhe deri më sot nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret nga komuna për sanimin e saj. Në gjendje shumë të keqe është edhe rruga në mes dy fshatrave, Zoqisht dhe Retijë, ku një pjesë e asfaltit është shembur. Kjo gjendje paraqet rrezik të lart për qytetarët dhe për të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Kërkoj nga organet komunale, që të ndërmarrin masa urgjente për rehabilitimin e tyre, sidomos në pjesët më të dëmtuara. Një shqetësim tjetër serioz është edhe mungesa e anësorëve mbrojtëse përgjatë këtyre dy rrugëve. Duke pasur parasysh që në afërsi ka zona të rrezikshme dhe humnera, pra në çdo devijim të mundshëm të automjeteve mund të ketë rrezik me pasoja fatale. Qytetarët meritojnë rrugë të sigurta dhe infrastrukturë funksionale, prandaj pres që këto kërkesa të trajtohen me prioritet dhe të kalojnë nga fjalët në veprime konkrete.

Sali Sallteku: E kam një kërkesë dhe besoj që është modeste për drejtorin e Shërbimeve Publike. Mbi 300m është rruga në mes Gexhës dhe Radostës pa ndriçim. Në fakt dritat të shpërndara, vetëm shtyllat duhet t'i blejmë. Në atë zonë nuk ka gjithashtu kanalizim. Janë mbi 10 familje, ka biznese si dhe hotele.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Një pyetje për drejtorinë e Shërbimeve Publike: Rruga “Jahja Danuza” ka disa vite që është në gjendje të mjerueshme. A keni ndonjë plan konkret për rregullimin e kësaj rruge?

Jusuf Dërmala: Një propozim për drejtorinë e Bujqësisë, nëse ka mjete gjatë këtij viti apo edhe në vitin e ardhshëm: Është mirë të planifikohet subvencionimi i pemëve manore. Të llogaritet kostoja e kësaj dhe të bëhet një analizë e profitabilitetit të këtyre pemëve. Po ashtu, edhe te bimët medicinale është një çështje që duhet të planifikohet, për shkak kushteve specifike që kërkojnë.

Behlul Krasniqi: Përshëndetje, kryesues! E kam një kërkesë për drejtorin e drejtorisë së Shërbimeve Publike në lidhje me një lagje në fshatin Senoc, banorët e së cilës kanë problem me ujërat e zeza dhe janë diku 7 shtëpi. Ka më shumë se një muaj që nuk janë të kyçur në rrjetin e kanalizimit. Më herët kanë qenë të kyçur në një pronë private dhe pronari privat tani iu ka bërë çkyçjen e kanalizimit. A ka mundësi për ndonjë zgjidhje?

Lendrit Morina: Faleminderit, kryesues! Të nderuar drejtorë të drejtorive, asambleistë, media dhe ju të pranishëm. E kam një kërkesë për drejtorinë e Shërbimeve Publike: Kërkesa ka të bëjë për zgjidhjen e problemit për kthimin e ujërave të zeza në fshatin Xërxë. Veçanërisht gjatë reshjeve të shiut, ku si pasojë e mbingarkesës së sistemit të kanalizimit ujërat e zeza kthehen prapa nëpër shtëpi dhe oborre, duke shkaktuar rrezik për shëndetin publik. Ky problem qëndron i vazhdueshëm në Xërxë. Kërkoj nga drejtori që ta shqyrtojë mundësinë për një impiant në Xërxë.

Yllka Shehu: Faleminderit i nderuar kryesues, përshëndetje për të gjithë! E kam një pyetje për drejtorin që sapo erdhi, të cilit fillimisht ia uroj ditëlindjen. Të gjithë e kemi mirëpritur vendimin për shtesat e nënave që lindin në Rahovec, por pyetja ime është: a ka gjinekolog që punon me orar të rregullt në QKMF. Sipas informatave, gjinekologu punon vetëm në orar kujdestarie, ku edhe nënat tani detyrohen të lindin në qytete të tjera, në Prizren e Gjakovë.

Zana Qanta: Faleminderit, kryesues! Meqenëse u përmend çështja e shtëpisë së pleqve. Po ndërlihem me këtë çështje shumë të rëndësishme për mirëqenien e të moshuarve në komunën tonë. Një dështim që e reflekton mendësinë e qeverisjes suaj, ku i jepni vetes të drejtën të shtyni përpara projekte që nuk pranohen nga shoqëria, duke tentuar t'ua impononi qytetarëve, ndërsa një projekt kaq shumë i rëndësishëm, ku në fillim të mandatit të katërt të qeverisjes suaj, nuk do të duhej të ishte fare temë diskutimi. Edhe pse e keni marrë besimin e qytetarëve përmes votës, nuk po reflektoni aspak ndaj kërkesave të tyre të vazhdueshme. Ndërkohë, vërehet që për objekte dhe për kategori të

ndryshme të shoqërisë janë gjetur zgjidhjet dhe funksionet alternative, ndërsa për këtë kategori kaq të ndjeshme vazhdon të mungojë një zgjidhje konkrete dhe e qëndrueshme. Propozoj që, hapësira ngjitur me “Shehu-TEX” përballë kafesë “Prive” është një lokacion i përshtatshëm për ndërtimin e një vendqëndrimi për të moshuarit. Kjo zonë ofron qasje, sepse është e pozicionuar mirë brenda qytetit. Një investim i tillë është obligim institucional ndaj atyre që tërë jetën kanë kontribuar për neve si shoqëri. Prandaj, kërkoj që kjo çështje të trajtohet me prioritet dhe të përfshihet në planifikimet konkrete të investimeve.

Nehar Shala: Faleminderit, kryesues! Dua ta ngris një çështje sa i përket shënjimit të rrugëve nëpër vendbanime. Nëse kjo është kompetencë e komunës është mirë të ndërmerrni diçka, nëse është kompetencë e instancave më të larta, është mirë që të bëni kërkesë. Kjo ka të bëjë me shumë rreth objekteve dhe monumenteve të rëndësishme të veçantë – objektet e kultit fetar dhe monumentet me motive historike. Konkretisht jam duke folur për memorialin e varrezave në Krushë të Madhe. Është mirë që komuna t’i vendosë disa shenja orientuese, sepse zakonisht këto monumente tërheqin edhe vizitorë jashtë komunës sonë. Gjithashtu e kam edhe një pyetje, por fillimisht e përgëzoj publikisht drejtorin Mullaabazi për projektin e fundit të rruga “Arif Shala”. Drejtor, a ka shpresë për rrugën “Avdyl Zeqiri”, e cila njëjtë si rruga “Arif Shala” është veç pak nën rrugën kryesore, pra e njëjta gjendje ashtu siç ka qenë rruga “Arif Shala”. Në momentin që bjen shi, aty nuk mund të kalosh me traktor, në këmbë jo se jo.

Bujar Mustafa: Në këtë kohë të vështirë, ku çmimet e derivateve janë rritur shumë dhe janë bërë të papërballueshme, sidomos për fermerët blektorë, të cilët i punojnë sipërfaqet më të mëdha të tokës. Diskutova me ish-drejtorin Beratin dhe drejtorin aktual Beharin, më treguan që nuk ka buxhet, por unë po insjtoj: Duhet t’ju dalim në ndihmë, duke gjetur një formë që edhe ata të përfshihen me një skemë subvencionale. Një projekt-propozim të detajuar me baza ligjore e me shifra, sa i përket blektorisë, prodhuesëve të qumështit dhe mishit, ia kam dorëzuar drejtorit Behar dhe ka mbetur për shqyrtim.

Lirigzon Kastrati: Për drejtorinë e Bujqësisë: Te rregullimi i rrugëve fushore, përfaqësuesi i fshatit ka bërë kërkesë dhe i keni kthyer përgjigje që shumë shpejt do të marrim veprim. Kur pritët të fillojë rregullimi i rrugëve fushore në Hoçë të Vogël? Gjendja është e mjerueshme dhe bujqit vazhdimisht ankohen. Pres që brenda javës drejtori të na vizitojë dhe të njoftohet për gjendjen reale. Për drejtorinë e Administratës: Më pëlqej një vendim për shërbyesit civilë, për kompensimin vjetor për financim të ushqimit. A keni menduar ndonjëherë ta merrni ndonjë vendim të tillë? Për drejtorinë e Shërbimeve Publike: Çështja e largimit të deponive të mbeturinave. Ka ardhur një kërkesë dhe besoj që javën që vjen do t’i vizitojë vendet e ngjarjes, që të marrë veprime konkrete në këtë drejtim.

Lendrit Morina: Pasi jemi në muajin mars, në muajin e dhimbjes dhe kujtimeve, por njëherit edhe krenarisë. E kam një propozim për drejtorin e Arsimit: Duke u bazuar në rëndësinë historike kombëtare të ngjarjeve tragjike që kanë ndodhur në komunën e Rahovecit, gjatë luftës së vitit 1999, veçanërisht në masakrat në Krushë të Madhe, Celinë, Fortesë, Brestoc dhe Pastasel, kërkoj që nga viti i ardhshëm nga muaji mars, në të gjitha institucionet arsimore të komunës sonë të organizohet nga një orë shtesë në javë. Ora mësimore (1 orë në javë gjatë muajit mars) të ketë për qëllim përkujtimin e viktimave të luftës dhe nderimin e sakrificës, vetëdijesimin e nxënësve për historinë e vendit dhe veçanërisht për komunën tonë. Kjo iniciativë ka rëndësi të veçantë edukative-kombëtare dhe ndikon në ruajtjen e kujtesës kolektive.

Sarandë Sallteku: E pata një pyetje për drejtorinë e Shërbimeve Publike: Kur do të vazhdojë ndriçimi në dy lagje të Malësisë së Vogël? Në qendër të fshatit Gexhë, banorët kanë pasur probleme me kanalizim vitin e kaluar. A kanë filluar punimet aty, nëse jo kur do të fillojnë?

Defrim Kafexhiu: Po i bëj edhe unë disa pyetje! Shumica e pyetjeve ishin për drejtorin e shërbimeve publike, kjo gjë e tregon efikasitetin ose mangësitë e punës. Drejtor, në lagjen “Vëllezërit Frashëri” puna e kanalizimit është zgjidhur për një segment të disa shtëpive, a po punohet të zgjidhet për pjesën tjetër të shtëpive të mbetura që nuk kanë qasje në rrjetin e kanalizimit? Një pyetje tjetër, po nuk e di saktë emrin e rrugës, te shkolla “Sadedin Hajda” mungon ndriçimi publik dhe ka më shumë se dy muaj! Pse nuk ka ndriçim publik? Në rregulloren që e plotësuam dhe ndryshuam, KEDS-i që i bën investimet në ndërrimin e shtyllave, fillimisht e merr lejen prej drejtorisë së Shërbimeve Publike, në anën tjetër unë kam pasur shumë ankesa të qytetarëve që shtyllat po vendosen në prona private, pa njoftim paraprak. A është e njoftuar drejtoria për këtë gjë dhe a e ka planin investiv të KEDS-it? Nëse është e mundur që,

drejtoria e Shërbimeve Publike ta njoftojë pronarin e pronës apo t'i njoftojë shtëpitë afër, para vendosjes së shtyllës në atë pronë, ose të pozicionet në një vend më të përshtatshëm që nuk do të sillte telashe në mes tyre.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Edhe një pyetje për drejtorinë e Shërbimeve Publike: Te rruga “Gani Mullabazi” është në grop goxha e madhe, e cila po shkakton rrjedhje të ujit nëpër parcela të ndryshme. Kam pasur adresime të qytetarëve për këtë rast.

Kryesuesi: Faleminderit! Besoj që Sekretaria e Kuvendit do t'i nxjerr të gjitha pyetjet e bëra dhe pastaj në seancën tjetër, secili nga drejtorët do t'ju përgjigjet, qoftë me shkrim ose me gojë.

Kryetari: Faleminderit! Nuk e pata rastin të jem nga fillimi, sepse ishim në Glllogjan, por i kam premtuar Neharit që do t'i përgjigjem për qentë endacakë. E vërtetë që është i pamjaftueshëm trajtimi deri më sot. Jemi duke e shqyrtuar mundësinë me një projekt tjetër, si lloj vetëushqyerje. Çështja e KEDS-it: Krusha e Madhe është pjesë rajonit të Prizrenit dhe gjasat janë që të kemi vështirësi ndoshta edhe për pak kohë, mirëpo unë e kam potencuar që me ndërtimin e nënstacionit në Malishevë, mundësitë janë reale që të stabilizohet gjendja e furnizimit me energji elektrike. Çështja e tretë ka të bëjë me muzeun: Është e vërtetë që, aty si të punësuar të kontraktuar e kemi vetëm një njëri, Irfon Ramadani, i cili edhe pak ditë ka kontratë. Në rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës e kemi paraparë sektorin për trashëgimi, sepse kemi shumë muze, në Krushë të Madhe i kemi 3 muze, kemi në Rahovec, në Retijë, në Drenoc e Mrasor. E kemi kullën e “Tonit e Micit”, si dhe kompleksin në Gradish, ndërsa nuk kemi kuadro që të rekrutojmë njerëz adekuat për këto lëmi. Në plotësim-ndryshimin e statutit, pra në projekt-statut do të propozoj edhe drejtori që do të lidhen me investime në trashëgimi dhe të mërgatës. Do t'i kemi të parapara edhe dy drejtori shtesë.

Defrim Kafexhiu: Meqenëse e përmende plotësim-ndryshimin e statutit të Komunës së Rahovecit, si pjesë e këtij e plotësim-ndryshimi është edhe ndryshimi i logos së komunës. Kuvendi si institucion e meriton të dijë se ku është procesi i ndryshimit të logos. Grupi punues është njoftuar dhe e kemi pasur një takim me nënkryetari. Koncepti i logos është prezantuar para nesh, por besoj që është e udhës që në seancën tjetër është mirë që edhe anëtarët e kuvendit të njoftohen me logon. Është më mirë të njoftohemi, sepse nëse nuk ka pëlqyeshmëri për atë logo, atëherë të përfundohet si proces me përfundimin e plotësim-ndryshimin e rregullores. Pra, të mos zhagohej procesi i ndryshim-plotësimit të rregullores shkaku i logos. Është mirë të mbahet edhe ndonjë konsultim publik me grupet e interesit dhe në fund të jemi të gjithë të kënaqur me logon e ndryshuar të komunës.

Kryetari: Grupi punues është i përbërë me të gjitha subjektet politike, gjithashtu edhe unë jam aty. E kemi një kompani të kontraktuar, e cila e ka punuar logon. I kam parë disa prej versioneve të logos, por në takimin e dytë, krahas plotësim-ndryshimeve në statut do të bisedojmë edhe për logo, si dhe do ta thërrasim autorin e logos për prezantim. Natyrisht që projektin për ndryshimin e statutit, para se të vij në kuvend i nënshtrohet diskutimit publik. Të them të drejtën, parimisht si logo më ka pëlqyer, vetëm te ngjyra duhet ta shikojmë. Pas përfundimit të procedurave, në kuvend, në rend dite, pika e ndryshimit dhe plotësimit të statutit mund të jetë në muajin qershor apo korrik. Dua t'ju them edhe diçka – burra, gra, djem e çika, 2.140.000 na ka marrë thesari. Të gjitha këto janë kryesisht për shkak të kontratës kolektive, si dhe për shkak të 20% gjatë kohës së pandemisë (266.000€). Nuk e dimë kur ndalet kjo, por shpresojmë që është viti i fundit që thesari na tërheq para. Përndryshe, ky vit është mjaft i vështirë.

Kryesuesi: Urdhëro, Lirigzon! Nëse dëshironi t'i përsëritni pyetjet, kryetarin e kemi këtu dhe mund të vazhdojmë!

Lirigzon Kastrati: Sigurisht që është shqetësim, kjo tërheqje prej 2 milion nga investimet kapitale. Drejtori, në vitin e kaluar e ka paraqitur një gjendje dhe për afërsisht borxhi ka qenë 3 milion. Kërkoj që në seancën e radhës ta dimë se sa kanë mbetur pa u paguar nga kontrata kolektive?

Kryetari: Nuk e dimë saktë se në cilat projekte janë tërhequr, veç e dimë që bujqësia është goditur fort, urbanizmi, arsimit dhe shërbimet publike.

Kryesuesi: Faleminderit! Para se ta përfundojmë seancën, dua të bëj një vërejtje për Ekonomia Online. Nuk ka transmetim direkt! Është punë e juaj nëse ka internet ose jo, qytetarët kanë të drejtë të na shohin direkt. Tre informata blic: Nesër është trajnimi informues në Gjakovë, më datë 25, në ora 10:30 në Qarshinë e Jupave. Më datë 26 dhe 27 mars është konfirmuar vizita studimore e dy asambleve, Mallakastër dhe Mirditë nga Shqipëria. Ata vinë rreth orës 13:00. Të paktën anëtarët e KPF-së është mirë të jenë të pranishëm dhe në koordinim me drejtorin e kulturës do ta

bëjmë një agjendë për dy ditë sa do të jenë ata këtu. Si informatë e tretë: besoj që shumë shpejt do t'i keni pajisjet kompjuterike secili dhe do të shkarkohemi prej këtyre materialeve fizike. Ju dëshiroj ditë të mbarë e vikend të mirë.

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi

